



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	12.01.24	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.	01	Numri	60/01-1640
			Shtojcë	

Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2024

Raporti i punës së KKSBB –së për vitin 2023

Takimi i parë i KKSBB për vitin 2023 është mbajtur më **23.02.2023** të këtij viti të cilin e ka udhëhequr Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Gjendja e rrugëve dhe mirëmbajtja dimërore
- 4.Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSBB gjat vitit 2022
- 5.Të ndryshme

Për gjendjen e sigurisë në komunën tonë ka raportuar Komandanti i Stacionit të Policisë i cili raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve si dhe ofroi një njoftim mbi sfidat dhe të arriturat për vitin 2022.

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime :

- 1.Të inspektohen bizneset lidhur me respektimin e kushteve sipas rregullave në fuqi dhe të tregojnë kujdesë maksimal ndaj produkteve që tregtojnë.
- 2.Të merren masa ndaj bizneseve që u shërbejnë fëmijëve produkte të duhanit dhe pije alkoolike .
- 3.Të respektohet ligji kundër pirjes së duhanit në hapsira të mbyllura.
- 4.Të merren masa ndaj pronarëve të kafiterive të cilët përdorin trotualet për shërbime e reklama.

Takimi i dytë i KKSBB është mbajtur më **27.04.2023** që është kryesuar nga Kryetari i Komunës dhe janë diskutuar tema të ndryshme që prekin sigurinë e qytetarëve . Për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i stacionit të Policisë në Kaçanik

z. Halim Shehu i cili e cilësoi si të qetë por që shqetësuese ai paraqiti gjendjen e pyjeve sidomos të pjesës së parkut nacional e cila nuk po menagjohet si duhet nga niveli qendrorë.

Pikat e rendit të ditës nga ky takim ishin:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Menagjimi i Emergjencave -Fatkeqsitë Natyrore
- 4.Informatë për punën e inspektorëve komunal për vitin 2022
- 5.Të ndryshme

Rekomandimet nga ky takim ishin:

- 1.Të ndërmerren masa ndaj pronarëve të bizneseve që ekspozojnë mallrat në trotuare.
- 2.Të bëhet një plan i mirfilltë për emergjenca dhe për fatkeqsitë natyrore.
- 3.Të paisen objektet institucionale me aparate për fikjen e zjarrit si dhe të vendosen shenjat orientuese nëpër këto objekte.
- 4.Të vendosen hidrante në të gjitha lokalitetet që janë në sistemin e ujësjellësit

Mbledhja e tretë e KKSB duke ju referuar edhe Planit të Punës për vitin 2023 është mbajtur më datë **27.06.2023** i kryesuar nga Nënkryetari i Komunës z. Sabedin Vishi me këto pika të rendit të ditës:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Përgatitje rreth sfidave eventuale gjat sezonit verorë
- 4.Të ndryshme

Për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë z.Halim Shehu.

Sipas Komandantit të Policisë në këtë periudhë kohore ka pasur rritje të veprave kriminale e si më shqetësuese ai theksoi dhunën në familje dhe dëmtimi i pyjeve në pjesën e parkut nacional ku si pasojë është keqmenaxhimi nga niveli qendrorë.

Si sfidë Komandanti i Policisë e paraqiti edhe numrin e vogël të zyrtarëve policorë për shkak të gjendjes së krijuar në veriun e Kosovës ku një pjesë e këtyre zyrtarëve janë të angazhuar në këtë pjesë.

Rekomandimet e nxjerrura nga kjo mbledhje ishin:

1. Të ju bëhet presion më i madh nivelit qendrorë për një menagjim më të mirë të pjesës së Parkut Nacional apo të gjindet një formë për ruajtjen e kësaj pjese nga keqbërësit.
2. Të vetëdijsohen qytetarët për dhënje të informacioneve për parandalim të dukurive negative .
3. Një koordinim më i mirë i institucioneve të sigurisë në parandalimin e dukurive negative në shoqëri
4. Të rritet gadishmëria për sfidat që mundë ti kemi gjat sezonit veror lidhur me zjarret
5. Të mirren në konsideratë rekomandimet e nivelit qendrorë për të punuar në preventivë për të ju shmangur pasojave që mundë të ndodhin në rast të ndonjë fatkeqsie natyrore.

Mbledhja e IV-të është mbajtur më datë **30.08.2023** të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës dhe kishte këtë rend ditë:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
3. Trajtimi i ambientit dhe menagjimi i mbeturinave
4. Të ndryshme

Për situatën e sigurisë raportoi zv.Komandanti i Stacionit të Policisë në Kaçanik z.Jaser Jaha, ku sipas tij në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile edhe pse kjo periudhë kohore ka qenë e ngarkuar përshkak të fluksit të madh të diasporës. Sipas tij të gjitha planet operative janë në realizim e sipër falë edhe punësimit të disa zyrtarëve të rinjë policorë.

Në këtë takim pos anëtarëve të KKSB për shkak se është diskutuar edhe Trajtimi i ambientit dhe menagjimi i mbeturinave, kan marrë pjesë edhe përfajqsues nga Kompania „Pastërtia” dhe nga Organizata për mbrojtjen e mjedisit OMM „Gjethi”

Rekomandimet e nxjerrura nga ky takim ishin:

1. Të sigurohen hapsira për deponitë ilegale
2. Makineritë e kompanisë „Pastërtia” të jenë të pastruara me qëllim të evitimit të kudërmimit të erërave .
3. Tolerancë 0 për ata që ndotin dhe shkatrojnë mjedisin

4.Kontrolla më të shpeshta në lokalet që frekuentojnë të rinjët me qëllim të parandalimit të dukurive negative

5.Kujdes i shtuar për eliminimin e ujrave të zeza nëpër rrugë dhe lumenjë

6.Angazhim në sigurimin e kamerave të sigurisë në qytet

Mbledhja e radhës është mbajtur më datë **31.10.2023** të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës dhe kishte këto pika të rendit të ditës:

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut

3.Trajtimi i ankesave të qytetarëve mbi sigurinë e përgjithshme

4.Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të Punës së KKSB për vitin 2024

5.Të ndryshme

Mbi gjendjen e sigurisë për periudhën në mes dy takimeve raporto Komandanti i Policisë në Kaçanik z.Halim Shehu të cilën e cilësoi të qetë dhe stabile por që sipas tij shqetësuese është rritja e dukurisë së dhunës në familje.

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime:

1.Të mirren masa rigoroze ndaj atyre që pengojnë ushtrimin e detyrës zyrtare

2.Të mirren masa ndaj grupeve jasht shkollore që pengojnë procesin mësimorë

3.Bashkëpunim edhe më i mirë ndërinstytucional në pengimin e dukurive negative në shoqëri

Mbledhja e VI-të dhe e fundit për këtë vit është mbajtur më datë **14.12.2023** të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës dhe ishin këto pika të rendit të ditës:

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut

3.Përgatitja e përballjes me sfidat në sezonin e dimrit

4.Aprovimi i Planit të Punës për vitin 2024

5.Të ndryshme

Sipas ekzekutivit komunal janë marrë të gjitha masat e përballjes eventuale të sfidave që mundë të paraqiten në sezonin e dimrit.

I vetmi rekomandim nga ky takim ishte që në rast se do të përballemi me një dimër të fortë pastrami i rrugëve nga bora të filloj me pjesët e rrugëve që janë me më prioritet.

Më datë **17.11.2023** disa anëtarë të KKSBB kanë marrë pjesë në një puntori rajonale një ditore në Ferizaj me temë „*Riintegrimi i luftëtarve të huaj të kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak dhe familjeve të tyre si dhe personave tjerë të radikalizuar*”, organizuar nga Organizata IOM (Organizata Ndërkombetare për Migracion) së bashku me Divizionin e Parandalimit dhe Riintegrimin (DPR) të Ministrisë së Punëve të Brendshme

Temat kryesore që janë diskutuar në takimet e KKSBB në mënyrë më detajuar janë të publikuara në web.faqën e Komunës në folderin e sigurisë.

Të gjitha këto tema janë paraparë edhe në planin e Punës së KKSBB-së për vitin 2023 por që janë diskutuar edhe për tema të aktualitetit që ndërlidhen me qështjen e sigurisë.

5 procesverbalet e mbledhjeve nga 6 që janë mbajtur si dhe materjale të tjera sa i përket këtij këshilli janë të publikuar në web. faqën e Komunës

Monitorues në disa takime ishte përfajqsuesi OSBE-së .

Kaçanik ,më 12.01.2025

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

